



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës  
Ministarstvo Infrastrukture  
Ministry of Infrastructure

Ministri i Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 319 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/L-70 Për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, nenin 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 dhe nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV 01/2013**  
**MBI STABILIMENTET DHE PAJISJET PËR NGASJE TË AUTOMJETEVE MOTORIKE**  
**ME GAZ**

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim përshkruhen kushtet të cilat duhet ti plotësojnë stabilimentet dhe pajisjet për ngasje të automjeteve motorike me gaz, procedura dhe mënyra e montimit të stabilimenteve dhe pajisjeve, përgatitura profesionale e teknikëve të cilët e kryejnë montimin dhe kushtet për punëtoritë e servisimit në të cilat montohen stabilimentet dhe pajisjet.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim:

1.1 **Gazi** - paraqet gazin e naftës të lëngët me shenjën UN 1965 (përzierje e propanit dhe butanit, në tekstin vijues: GNL; shenjë ndërkombëtare LPG – Liquefied Petroleum Gas), dhe gazi i shtypshëm natyror me shenjën UN 1971, shtypja punuese e të cilit nuk kalon 22 MPa (220 bar) (në tekstin vijues: metan shenja ndërkombëtare CNG= Compressed Natyral Gas).

1.2 **Shtypja** - konsiderohet shtypja mbi shtypjen atmosferike të ajrit (mbishtypja).

1.3 **Përqendrimi i rrezikshëm i gazit** - sasia e gazit në përzierje me ajrin e cila është e barabartë ose më madhe se 10% të kufirit të poshtëm të eksplozivitetit. Kufiri i poshtëm i eksplozivitetit për GNL është 1.7 vol.%, ndërsa për metan 4,4 vol.%.

1.4 **Punëtoria për servisim** - punëtoria për montimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve dhe pajisjeve për gaz për ngasjen e automjeteve motorike me gaz, e cila ka licencën e Ministrisë së Infrastrukturës.

1.5 **Tekniku për montim** - punëtori i punëorisë për servisim i cili ka së paku përgatitjen e mesme profesionale të drejtimit mekanik, makinerik, elektroteknik, informatik, ose mekatronik dhe i cili është i aftësuar për montimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz (sipas programit të aftësimit të cilin e harton institucion i autorizuar për atestimin dhe certifikimin e automjeteve me ngasje me gaz në marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës) të cilin e tregon me dokumentin e institucionit të autorizuar.

**1.6 Përfaqësuesi i autorizuar për stabilimente dhe pajisje, është personi juridik, i cili nga ana e prodhuesit të stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz, është autorizuar për nënshkrimin e kontratës për bashkëpunim tekniko asfalist me punëtoritë për servisim, aftësimin e teknikëve për montim (për çka lëshon vërtetim) dhe sigurimin e përkrahjes teknike, si dhe dhënien e dokumentacionit të nevojshëm institucionit të autorizuar për atestimin dhe certifikimin automjeteve motorike me ngasje me gaz.**

**1.7 Institucioni i autorizuar për atestimin dhe certifikimin e automjeteve për ngasje me gaz - institucioni të cilin e autorizon Ministria e Infrastrukturës sipas kushteve të parapara me këtë udhëzim.**

**Neni 3**  
**Stabilimentet dhe pajisjet**

1. Stabilimentet dhe pajisjet të cilat montoohen në automjete motorike për ngasje me gaz janë:

- 1.1 Rezervuari i gazit;
- 1.2 Armatura e rezervuarit për gaz;
- 1.3 Pastruesi (filtri) i gazit (me presion të ulët dhe të lart të shtypjes së gazit);
- 1.4 Avulluesi i gazit (GNL);
- 1.5 Rregullatori i shtypjes;
- 1.6 Valvola e gazit;
- 1.7 Kyçesi për zbrasje (vetëm për metan);
- 1.8 Valvola për furnizim me lëndë djegëse (benzinë ose diesel)
- 1.9 Gypat për gaz me shtypje të lartë;
- 1.10 Gypat për gaz me shtypje të ulët;
- 1.11 Gypat për mediumet për nxehje;
- 1.12 Instalimet elektrike dhë pajisjet;
- 1.13 Senzorët e shtypjes dhe të temperaturës;
- 1.14 Stabilimenti për injektimin e gazit;
- 1.15 Shpërndarësi;
- 1.16 Njësia elektronike kontrolluese;
- 1.17 Pompa e shtypjes së lartë (për GNL).

**Neni 4**  
**Kushtet të cilat duhet plotësuar materiali për stabilimentet dhe pajisjet**

1. Pjesët e pajisjeve dhe stabilimenteve nga neni 6. i këtij Udhëzimi të cilat janë në kontakt me gazin duhet të punohen nga materiali i cili:

- 1.1 nuk formon përzierje ndezëse;

1.2. është i rezistueshëm nga veprimi i gazit;

1.3. nuk i ndryshon vetit kimike të gazit.

**Neni 5**  
**Kushtet e punës**

1. Stabilimentet dhe pajisjet nga neni 3. pikat 1,2,3,6,7,9,10,13,14,15 dhe 17, të këtij udhëzimi duhet të jenë të konstruktuar dhe të punuara për temperaturën punuese prej -20 °C deri në 80 °C.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij nenit nuk ka të bëjë me shtëpizën mbrojtëse të armaturës së rezervuarit të gazit nga neni 9, paragrafi 12, pika 3 e këtij udhëzimi.

3. Stabilimentet dhe pajisjet nga neni 3 pikat 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet të jenë të konstruktuar dhe të punuara për temperaturën punuese prej -20 °C deri në 120 °C.

4. Stabilimentet dhe pajisjet nga neni 3 i këtij udhëzimi, përpjekje për gaz të shtrypjes së ulët atestohen për:

4.1 GNL në shtrypjen provuese prej 2,5 MPa (25 bar), rrespektivisht 3MPa (30 bar);

4.2 Metan, në shtrypjen provuese prej 30 MPa (300 bar).

5. Stabilimentet dhe pajisjet nga neni 3 i këtij udhëzimi përpjekje pika 9 dhe 10, duhet të jenë të atestuara dhe kenë miratim të vlefshëm të tipit.

6. Dokumentacionin mbi miratimin e tipit nga paragrafi 5 i këtij nenit, është i obliguar ta siguroj përfaqësuesi i autorizuar për stabilimente dhe pajisje dhe t'i prezantoj institucionit të autorizuar më së largu një muaj para montimit të parë të stabilimentit respektivisht pajisjes.

**Neni 6**  
**Karakteristikat e pajisjeve**

1. Stabilimentet dhe pajisjet nga neni 3 pikat 2 deri në 7 të këtij udhëzimi duhet me qenë të shënuar me numrin e certifikatës së miratimit dhe emrin e prodhuesit.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij *neni* nuk ka të bëj me gypat përrrezatim nga neni 9 paragrafi 1 pika 3 të këtij udhëzimi.

3. Rezervuari i gazit nga neni 3. pika 1. e këtij Udhëzimi duhet me i pas në mënyrë të përhershme të shtrypura këto shëname:

1.1 emrin e prodhuesit;

1.2 numrin e fabrikës;

1.3 vitin e prodhimit;

1.4 emrin e gazit me të cilin mbushet (përzierja propan-butan ose metan);

1.5 vëllimin e enës së zbrazët në litra (l);

1.6 për GNL: masën maksimale të lejuar të mbushjes (kg);

1.7 për metan: shtypjen maksimale të lejuar të mbushjes (MPa) respektivisht (bar);

1.8 Rezervuari i homologuar duhet ti ketë në mënyrë të përhershme të shtypura të dhënat në përshtatje me urdhëresat e rregullores përkatëse ECE R67 respektivisht ECE R 110.

**Neni 7  
Kushtet për rezervuarin e gazit**

1. Rezervuari i gazit, i cili montohet në automjetin motorik për ngasje me gaz, në kuptimin e urdhëresave ligjore dhe urdhëresave të rregullave të veçanta konsiderohet si ena nën shtypje.

2. Rezervuari i gazit i punuar në Republikën e Kosovës, i cili për herë të parë montohet në automjetin motorik me ngasje me gaz duhet të jetë i lejuar dhe i shënuar në përputhshmëri me dispozitat e rregullores ECE R67 respektivisht ECE R110.

3. Rezervuari i gazit i miratuar dhe i shënuar në përputhje më dispozitat e rregullores ECE R67 respektivisht ECE R110 mund të montohet në automjet pa atestim paraprak të tij.

**Neni 8  
Kushtet të cilat duhet ti plotësoj rezervuari i gazit**

1. Rezervuari i gazit i punuar jashtë Republikës së Kosovës duhet të ti plotësoj këto kushte:

1.1 Të jetë i miratuar dhe i shënuar në përputhje me dispozitat e rregullores ECE R67 respektivisht ECE R110;

1.2 Ketë dokumentacionin e miratimit nga institucioni i autorizuar;

1.3 Për automjete motorike me ngasje me gaz të cilat janë importuar duhet para regjistrimit të bëhet identifikimi dhe shikimi i dokumentacionit të verifikuar;

1.4 Rezervuari i dëmtuar gazit nuk guxon të shfrytëzohet;

1.5 Rezervuari i gazit për GNL dhe metan mund të jetë në përdorim më së gjati 10 vjet duke llogaritur nga data e prodhimit e shtypur në pllakën identifikuese;

1.6 Rezervuari i gazit i cili është i miratuar dhe i shënuar në përputhje me dispozitat e rregullores ECE R67 respektivisht ECE R110, mund të montohet në automjet pa atestim paraprak.

**Neni 9  
Armatura e rezervuarit të gazit**

1. Armatura e rezervuarit të gazit nga neni 3. pika 2 e këtij udhëzimi përbëhet nga:

1.1 valvola e rezervuarit të gazit;

1.2 pajisjet siguruese;

1.3 shtëpiza mbrojtëse e armaturës së rezervuarit të gazit respektivisht shtëpiza mbrojtëse e rezervuarit të gazit me armaturën përkatëse (shtëpiza e gazit e ngushtë me gypat për trezatim të jetë e realizuar edhe si mbrojtje nga dëmtimi mekanik);

1.3 kyçësi për mbushje;

15 valvola jokthyese e vendosur nē mes kyçësit pér mbushje dhe rezervuarit tē gazit;

1.6 valvola nē mes tē kyçësit pér mbushje dhe rezervuarit pér gaz, si dhe valvola nē mes tē kyçësit pér zbrasje dhe rezervuarit tē gazit;

1.8 treguesi i sasisë së gazit pér GNL (respektivisht matësit tē shtypjes pér metan).

3. Nē mes rezervuarit tē gazit dhe pajisjes nga paragrafi 1. pikat 1. dhe 2. tē këtij neni, nuk guxon tē jetë e montuar kurrfarë pajisje e cila mund tē pa mundësoj funksionimin e pajisjes së përmendura,

4. Pajisjet nga paragrafi 1. pika 7. duhet tē veproj gjatë kohës së mbushjes tē rezervuarit me gazit.

#### Neni 10

##### Valvola e rezervuarit tē gazit

Valvola e rezervuarit tē gazit është stabiliment i cili montohet drejtpërdrejtë nē rezervuar tē gazit dhe shërbën pér mbylljen e rezervuarit tē gazit kur duhet tē pengohet rrjedhja e pa dëshirueshme e gazit nga rezervuari.

#### Neni 11 Pajisjet siguruese

1. Pajisja siguruese nē armaturën e rezervuarit tē gazit duhet tē pengojë krijimin e shtypjes së lartë nē rezervuar si dhe rrjedhje tej mase tē gazit nga rezervuari, kur është e hapur valvola e rezervuarit.

2. Stabilimentet nga paragrafi 1 i këtij neni janë:

1.1 pér GNL:

- 1.1.1 kufizuesi i rrjedhjes;
- 1.1.2 pajisja pér sigurimin kundër shtypjes shumë tē lartë

1.2 pér metan:

- 1.2.1 kufizuesi i rrjedhjes;
- 1.2.2 pajisja pér sigurimin e kundër shtypjes shumë tē lartë;
- 1.2.3 pajisja kundër tejkalimit tē temperaturës nē rast zjarri.

3. Kufizuesi i rrjedhjes është pajisje siguruese e cila gjatë thyerjes së gypit pér përcjelljen e gazit duhet ta zgjegoj sasinë e gazit i cili do tē rrjedhë më së shumti 10% nga rrjedhja më e madhe e mundshme e gazit.

4. Pajisja pér sigurimin e kundër shtypjes shumë tē lartë, është pajisje siguruese e cila duhet që nē rezervuarin e gazit tē pengoj formimin e shtypjes më lartë se 3 (MPa) (30 bar),

5. Pajisja kundër tejkalimit tē temperaturës nē rast zjarri është pajisja siguruese e cila duhet tē lëshoj gaz nga rezervuari i gazit nē atmosferë nëse temperatura e pjesëve të sigurisë nē këtë pajisje arrin temperaturën  $100^{\circ}\text{C} \pm 5^{\circ}\text{C}$  (te rezervuari krejtësisht prej çeliku më së larti  $125^{\circ}\text{C} \pm 5^{\circ}\text{C}$ ). Kjo pajisje duhet realizuar ashtu që kur tē aktivizohet mos tē lejoj që shtypja nē rezervuar tē gazit tē këtë vlera më tē larta se 10% nga shtypja provuese e rezervuarit  $\pm 0,5$  (MPa) (5bar),

6. Pajisja siguruese në armaturën e rezervuarit të gazit dhe valvola rezervuarit të gazit mund të jenë të konstruktuara dhe realizuara ashtu që të krijojnë një tërësi.

#### Neni 12

##### Shtëpiza mbrojtëse montimi dhe funksionimi

1. Shtëpiza mbrojtëse e armaturës së rezervuarit të gazit respektivisht shtëpiza mbrojtëse e rezervuarit e gazit me armaturën përkatëse të rezervuarit të gazit duhet penguar rrjedhjen e mundshme të gazit nga pjesët e armaturës në hapësirën për vozitësin dhe udhëtarët, duke përfshirë edhe hapësirën e bagazhit.

2. Shtëpiza mbrojtëse e gazit nga paragrafi 1. e këtij neni është shtëpiza e ngushtë e gazit e cila duhet me qenë e konstruktuar, e realizuar dhe e provuar në jo rrjedhshmëri gjatë shtypjes prej 10 kPa (0.1 bar).

3. Shtëpiza mbrojtëse e gazit nga paragrafi 1, e këtij neni, dhe pjesët e armaturës të cilat ajo i mbron, duhet të kenë mbrojtje plotësuese nëse ekziston rreziku i dëmtimit mekanik të tyre në hapësirën përgarkësë (bagazh).

#### Neni 13

##### Kyçesi për mbushje

Kyçesi për mbushje është pajisje e cila mundëson mbushjen e rezervuarit me gaz vetëm me llojin caktuar të gazit dhe në shtypje të caktuar në përshtatje me realizimin rezervuarit të gazit.

#### Neni 14

##### Valvola jokthyese

1. Valvola jokthyese në mes të kyçësit për mbushje dhe rezervuarit të gazit është pajisje e cila duhet ta pengoj rrnymimin kthyes të gazit nga rezervuari i gazit kah kyçesi për mbushje.

#### Neni 15

##### Valvola në mes të kyçësit për mbushje kyçësit për zbrasje dhe rezervuarit.

Valvola në mes të kyçësit për mbushje, kyçësit për zbrasje dhe rezervuarit të gazit duhet me qenë të realizuar ashtu që gjatë kohës së mbushjes së rezervuarit me gaz të pamundësoj rrjedhjen e gazit në avullues, respektivisht në rregulator të shtypjes. Kur rezervuari nuk mbushet me gaz valvola duhet të mundësoj rrjedhje normale të gazit në avullues respektivisht në rregulator të shtypjes.

#### Neni 16

##### Treguesi i sasisë së gazit për GNL

1. Treguesi i sasisë së gazit për GNL sipas këtij Udhëzimi është pajisja e cila tregon sasinë e gazit në rezervuarin e gazit.

2. Matësi i shtypjes për metan tregon shtypjen e metanit në rezervuarin e gazit.

**Neni 17**  
**Pastruesi i gazit**

Pastruesi i gazit sipas këtij udhëzimi administrativ është pajisja cila pengon kalimin e papastërtisë nga rezervuari i gazit kah pajisjet tjera.

**Neni 18**  
**Avulluesi i gazit**

Avulluesi i gazit sipas këtij udhëzimi administrativ është pajisja në të cilin GNL avullohet dhe kalon nga gjendja e lëngët në atë të gazet nën ndikimin e nxhtësisë.

**Neni 19**  
**Rregulatori i shtypjes**

1. Rregulatori i shtypjes sipas këtij udhëzimi administrativ është pajisja në të cilën zvogëlohet shtypja e gazit nga shtypja në rezervuar dhe rregullohet në shtypjen pënuase i cili i përgjigjet formimit të përzierjes së përshtatshme për punë të motorit.
2. Si rregulator i shtypjes mund të përdoret vetëm pajisja me membrana.
3. Nëse rregulatori i shtypjes është realizuar si shumëshkallësh, shkalla e parë provohet në shtypjen sipas urdhëresës nga neni 5. paragrafi 4. të këtij udhëzimi, ndërsa shkallët tjera në shtypje dy herë më të larta se shtypja pënuuese.
4. Rregulatori i shtypjes duhet me qenë i realizuar ashtu që gazi nuk rrjedhë nga rregulatori kur motori nuk punon, respektivisht kur gazi nuk përdoret si lëndë djegëse për punën e motorit.

**Neni 20**  
**Valvolat e gazit**

Valvolat e gazit sipas këtij udhëzimi administrativ është pajisja e cila e ndërprenë rrjedhjen e gazit nga rezervuari në avulluesin e gazit dhe rregulatori të gazit kur motori nuk punon, respektivisht kur gazi nuk përdoret si lëndë djegëse për punën e motorit.

**Neni 21**  
**Valvola e lëndës djegëse të lëngët**

Valvola e lëndës djegëse të lëngët sipas këtij udhëzimi është stabiliment i cili mbyllë rrjedhjen e llojeve tjera të lëndëve djegëse (benzinës, naftës etj) në pajisjen për furnizim të motorit me lëndë djegëse, derisa motori furnizohet me gaz si lëndë djegëse.

Neni 22

## Gypat pēr gaz

1. Me gypat pér gaz tē shtypjes sē lartē sipas këtij udhëzimi administrativ nënkuptohen tē gjitha rrjetat qyopre prej kyçësit në distancë pér mbushje tē rezervuarit deri te rezervuari i gazit dhe nga rezervuari i gazit deri te avulluesi i gazit, respektivisht deri te rregulatori i shtypjes.
  2. Gypat e ngurtë dhe tē lakueshëm (elastik) dhe pjesët pér lidhjen e tyre guxojnë tē përdoren si gypa pér gaz tē shtypjes sē lartë vetëm nëse janë konstruktuar dhe realizuar së paku pér shtypjen provueset rezervuarit tē gazit.
  3. Materiali i gypave pér gaz tē shtypjes sē lartë është çeliku ose bakri, ndërsa materiali i pjesëve pér lidhje është çeliku ose mesingu.

Neni 23

### Gypat për gaz të shtypjes së ulët

Me gypat për gaz të shtypjes së ulët sipas këtij udhëzimi administrativ nënkuþtohen të gjitha rrjetat gypore nga rregullatorë i shtypjes deri te motorë.

Neni 24

### Gypat pér mjete pér nxehje

Me gypat për mjete për nxehje sipas këtij Udhëzimi nënkuptohen të gjitha rrjetat gypore të cilat lidhin avulluesin e gazit dhe regulatorin e shtypjes me pajisjet përfshirë ftohje ose me burimin tjetër përkatës të nxehësisë.

Nenj 25

#### **Pajisje elektrike me instalime**

Me pajisje elektrike dhe me instalime konsiderohen pajisjet që pjesët për lidhje të cilat pjesë elektrike dhe elektronike të pajisjeve dhe stabilimenteve për ngasje të automjeteve motorike me gazë i furnizojnë me energji elektrike të nevoishtme për punën e tyre të rregullt.

#### **IV. KUSHTET PËR PUNTORITË PËR SERVISIM**

Neni 26  
Hapësira e punëtorisë

- #### 1. Punētoria pēr servisim duhet tē ketē:

Hapësirën e punëtorisë jo më të vogël se 6m x 3m për pranimin e automjeteve motorike të kategorisë L, M1 ose N1 respektivisht hapësirën e punëtorisë me sipërfaqe jo më të vogël se 14 m x 4.5 m për pranimin e automjeteve të kategorisë M2, M3, N2 dhe N3.

- ## 1.1 Së paku një teknik për montim

1.2 Posedon pajisje e cila mundëson punë në automjet nga ana e poshtme, varësisht nga lloji i automjetit dhe lloji i gazit i cili montohet, me qëllim të pengimit të formimit të grumbujve të koncentrimeve të rrezikshme të gazit,

1.3 Veglat për punë mekanike, elektrike dhe të limarisë për realizimin e punëve të montimit, si dhe veglat e veçanta të cilat i parashesh prodhuesi i stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz.

1.4 Detektorin për konstatimin e pranisë së gazit.

1.5 Kontraten me përfaqësuesin e autorizuar për stabilimente dhe pajisje nga neni 3, pika 2 deri në 7 dhe 13 deri në 17 të këtij udhëzimi.

1.6 Deklaratën e furnizuesit mbi përshtatjen e gypave prej të cilëve janë punuar stabilimentet dhe pajisjet për ngasjen e automjeteve motorike me gaz nga neni 3, pika 9 e 10 e këtij udhëzimi nga neni 4 dhe neni 5 paragrafi 1 dhe 4 të këtij udhëzimi.

2. Përpos kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni punëtoria për servisim duhet ti plotësoj edhe kushet e përcaktuara me aktet e veçanta nga lëmia e mbrojtjes në punë dhe mbrojtja nga zjarri dhe eksplodimi.

3. Punëtoria për servisim është e obliguar të mbaj evidencën mbi stabilimente dhe pajisjet e montuara, servisimin e stabilimenteve dhe pajisjeve dhe të ruaj evidencën së paku 5 vjet.

#### Neni 27

#### Autorizimi për punë të punëtorisë për servisim

1. Licenca për dhënen e pëlqimit për punë të punëtorisë për servisim ipet në bazë të kërkesës.

1.1. Licenca epet për pesë (5) vite me mundësi vazhdimi dhe çmimi do të jetë 300 euro te cilat do të paguhen ne buxhetin e Kosovës .

2. Personi juridik i paraqet kërkesë Ministrisë së Infrastrukturës për dhënen e pëlqimit për punë të punëtorisë për servisim.

3. Komisioni kompetent me kontrollim vizuel dhe kontrollim të dokumentacionit përcaktojnë përbushjen e kushteve për punë të punëtorisë për servisim të parapara me këtë udhëzim dhe atë:

3.1 Institucioni i autorizuar kontrollon përbushjen e kushteve nga neni 26 paragrafi 1, pikat 1 deri në 7 të këtij udhëzimi,

3.2 Ministria përkatëse kontrollon përbushjen e kushteve nga neni 26 paragrafi 2 të këtij udhëzimi i cili ka të bëj me mbrojtjen nga zjarri dhe eksplodimi,

3.3 Inspektorati për mbrojtje në punë kontrollon kushtet nga neni 26 paragrafi 2 i këtij udhëzimi, i cili ka të bëj me mbrojtjen në punë.

4. Komisionet kompetente nga paragrafi 2 i këtij neni gjetjet dhe mendim mbi përbushjen e kushteve nga neni 26 i këtij udhëzimi ia paraqesin Ministrisë së Infrastrukturës.

5. Ministria e Infrastrukturës nxjerr vendim me të cilin lejon punën e punëtorisë për servisim.

**Neni 28**

**Kushtet për institucionin e autorizuar për atestimin dhe certifikimin e automjeteve motorike me ngasje me gaz**

1. Institucioni i autorizuar për atestimin dhe certifikimin e automjeteve motorike me ngasje me gaz sipas nenit **2 pika 7 e këtij udhëzimi** konsiderohet Institucioni i cili ka për detyrë që të bëj verifikimin e:

- 1.1 dokumentacionit të lëshuar nga punëtoria e servisimit;
- 1.2 rregullsisë së montimit të stabilimenteve dhe pajisjeve;
- 1.3 plotësimit të kushteve për stabilimentet dhe pajisjet, të parapara me këtë udhëzim;
- 1.4 aplikimit të masave për ngasje të sigurt në komunikacion.

2. Institucioni i Autorizuar në bazë të plotësimit të detyrave të paragrafit **1, pikat 1 deri ne 4**, të këtij **nemi**, lëshon certifikatën mbi plotësimin e kushteve të stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz sipas këtij udhëzimi.

3. Mjeti i cili i kalon atestin i nënshtrohet kontrollimit të rregult teknik të rregult dhe periodik sipas kriterieve të përcaktuara me ligj.

**Neni 29**

**Kushtet për marrjen e autorizimit**

1. Ministria e Infrastrukturës e autorizon një institucion me kompetencë përkatëse për atestimin dhe certifikimin e automjeteve motorike për ngasje me gaz ne bazë të procedurave ligjore përkatëse dhe shprehjes së interesit të cilat publikohen ne gazetat me tirazh të madh në Kosovë. Institucioni i autorizuar nga Ministria për atestimin dhe certifikimin e automjeteve motorike për ngasje me gaz, duhet ti plotësoj këto kushte:

1.1 Të ketë personelin profesional me kualifikime te larta shkolllore me përvojë min 3 vite nga lëmi i makinerisë, komunikacionit, enëve nën presion, sigurisë në komunikacion, mbrojtjes në punë me lëndë të rrezikshme;

1.2. Të posedon objektin adekuat Qendra për kontrollimin teknik të automjeteve) me të gjitha veglat dhe pajisjet (për atestimin e automjeteve motorike me ngasje me gaz);

1.3. Të posedon pajisjet te cilat mundësojnë punë në automjet nga ana e poshtme, varësisht nga lloji i automjetit dhe lloji i gazit i cili montohet, me qëllim të pengimit të formimit të grumbujve të koncentrimëve të rrezikshme të gazit;

1.4. Të posedon detektorë ose pajisjen me shkume për detektimin e pranisë së gazit.

2. Përveç kushteve të parapara në këtë Udhëzim Administrativ për marrjen e autorizimit, do të propozohen edhe kriterë shtesë nga Departamenti i Automjeteve të cilat do ti shqyrtoj dhe miratoj Ministri.

3. Autorizimi epet për pesë vite me mundësi vazhdimi dhe çmimi për të do të jetë 2000 euro të cilat do të paguhen në buxhetin e Kosovës.
4. Çmimorja për automjetet që dërgohen në kontrollë për matjen e gazrave për automjetet me plinë të cilat e kanë motorrin dhe pajisjet sipas parametrave të parapara me ketë Udhëzim Administrativ do të jetë 60 euro me TVSH

**Neni 30**  
**Montimi dhe mirëmbajtja**

1. Montimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasjen e automjeteve motorike me gaz, e kryen punëtoria për servisim e cila ka autorizimin nga neni 27 paragrafi 4 i këtij udhëzimi.
2. Punëtoria për servisim e cila i mtonon stabilimentet dhe pajisjet për ngasje të automjeteve motorike me gaz, mienjëherë pas montimit jep deklaratën mbi kryerjen e montimit, përbajtjen e të cilës e vërteton institucionin i autorizuar me pëlgjinin e Ministrisë së Infrastrukturës.

**Neni 31**  
**Montimi i pajisjeve me gaz**

1. Stabilimentet dhe pajisjet për ngasjen e automjeteve motorike me gaz duhet të montohen në automjet ashtu që të gjinden në kufijtë e gabariteve të automjeteve në të cilët janë montuar, përvëç nëpër lartësi e cila nuk guxon me qenë më e madhe se lartësia më e madhe e lejuar e automjetit.
2. Nxehja e drejtë për drejtë e stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz nuk është e lejuar.
3. Stabilimentet dhe pajisjet për ngasje të automjeteve motorike me gaz montohen në distancë prej 100 mm nga pajisia (kolektori) e zbrâzjes së gazrave. Distanca mundet me qenë edhe më e vogël nëse mes stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasjen e automjeteve motorike me gaz dhe pajisjes së zbrasjes së gazrave montohet mbrojtja përkatëse nga nxehësia.
4. Rezervuari për gaz montohet në automjet ashtu që shenjat respektivisht të dhënat nga neni 6 i këtij udhëzimi të janë lehtësish të lexueshme.
5. Stabilimentet dhe pajisjet për ngasjen e automjeteve motorike me gaz nga të cilët ekziston mundësia e rrjedhjes së gazit nuk guxojnë të janë të montuar në afersi të vrimave/gypave për ventilim/klimatizim të hapësirës për ngasësin dhe udhëtarët, duke përfshirë edhe bagazhin. Nëse yjen deri te rrjedha në pjesët e stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz, atëherë nuk guxon me ekzistuar mundësia që gazi që ka rrjedhë të vjen në hapësirë për vozitësin dhe udhëtarët, duke përfshirë edhe hapësirën për bagazh, p.sh. Nëpër gypat e ajrit për ngrohje ose gypat e ajrit për pajisjet për aklimatizim.
6. Pjerrtësitë, përdredhjet dhe lëkundjet e automjeteve motorikë nuk guxojnë me pësuesitë përfshirë edhe hapësirën për bagazh, p.sh. Nëpër gypat e ajrit për ngrohje ose gypat e ajrit për pajisjet për aklimatizim.
7. Shtrëngimet nuk guxojnë të realizohen me tehe të ashpra dhe nuk guxojnë me qenë të tillë që mund të dëmtojnë pjesët e stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz. Në rast të kontaktimit direkt të pjesëve metalike ekziston mundësia e korrodimit prandaj, duhet përdoren meshtresat përmes pengimin e korrodimit.

8. Rezervuari i gazit stabilimentet dhe pajisjet tjera për ngasje të automjeteve motorike me gaz duhet me qenë të montuara në automjet ashtu që të janë të mbrojtura nga dëmtimet mekanike, korrodimi dhe izolimi.

9. Përveç montimit, nuk lejohen të kryhen kurfarë punë tjera në pajisjet siguruese të rezervuarit për gaz.

#### Neni 32

##### Montimi i rezervuarit për gaz

1. Montimi i rezervuarit për gaz nuk guxon me e penguar stabilitetin e automjetit, as ngarkesat e lejuara të akseve.

2. Nëse janë montuar dy ose më tepër rezervuar të gazit për GNL, me valvola duhet të sigurohet mbushja individuale, respektivisht zbrajen e rezervarit.

3. Në shtëpizën e ngushtë mbrojtëse të gazit nuk guxojnë me qenë pajisjet elektrike përpos nëse janë realizuar me mbrojtje kundër eksplodimit.

#### Neni 33

##### Kufizimet dhe montimi i rezervuarit për gaz

1. Rezervari i gazit nuk guxon të montohet në hapësirën e motorit si dhe para aksit të parëm të automjetit.

2. Rezervauri i gazit montohet në automjetin motorik ashtu që:

2.1 gazrat dalës mos të drejtohen kah rezervari direkt apo indirekt,

2.2 gazi nga pajisja për sigurim kundër shtypjes së lartë ose nga lidhjet, as direkt e as indirekt, mos të jetë i drejtar kah gypi dalës në hapësirën për vozitës dhe udhëtarë, duke përfshirë edhe bagazhin, në hapësirën për motor, respektivisht në kah të burimit të mundshëm të shkëndijave (xixave) elektrike,

2.3 të jetë i mbrojtur nga veprimi i drejtpërdrejtë i rrezeve të diellit,

2.2 gazi nga rezervari i gazit për GNL mund të dalë vetëm në gjendje të lëngët,

2.5 Pika më e ulët e rezervuarit (me mbrojtës mekanik) gjatë ngarkimit të plotë të automjetit nuk është e larguar më pak se 150 mm nga bazamenti.

2.6 është i mbrojtur me mbrojtës mekanik, i cili është vendosur jo më pak se 10 mm nga rezervuari,

**Neni 34  
Përforcimi i rezervuarit për gaz**

1. Rezervari i gazit duhet me qenë i shtrënguar me së paku dy mbajtës, ashtu që të mbajnë ngarkesën e rezervuarit të mbushur gjatë nxitimit prej  $50 \text{ m/s}^2$  në kahe të vozitjes, në kahe të kundërt dhe normal të lëvizjes në rrashin horizontal, ndërsa në kahet tjera  $25 \text{ m/s}^2$ .

2. Shtrënguesit nga paragrafi 1, i këtij nenit nuk guxojnë ta dëmtojnë rezervarin e gazit mekanikisht e as në terti me të ta korrodojnë, ndërsa në mes të rezervarit dhe shtrënguesve duhet të vendoset materiali elastik i cili nuk e thith lagështinë.

**Neni 35  
Vendosja e rezervuarit për gaz**

1. Kur rezervari i gazit është vendosur në hapësirën për vozitës dhe udhëtarë, duke përfshirë edhe bagazhin, rezervari respektivisht pajisjet nga nenit 9. paragrafi 1, të këtij Udhëzimi, të cilët gjinden në rezervar, duhet me u vendosur në shtëpizën e ngushtë të gazit, për pengimin e grumbullimit të gazit dhe krijimin e përzierjes eksplozive me ajrin në përputhje me paragrafet 4 dhe 7 të këtij nenit.

2. Në mes të shtëpizës së ngushtë të gazit dhe rezervuarit të gazit dhe pajisjeve në te, nga paragrafi 1 i këtij nenit duhet të sigurohet hapësirë e lirë në mes të rezervarit dhe shtëpizës me gjërësi (lartësi) jo më pak se 20 mm.

3. Me mbrojtës nga veprimi i drejtpërdrejtë i rrezeve të diellit nënkuftohet mbajtësi metalik, i cili mbulon së paku gjysmën e epërme të rezervarit (harku prej  $180^\circ$ ) në distancë prej minimum 20 mm nga rezervari.

4. Me airim (ventilim) të shtëpizës së ngushtë për gaz nënkuftohet hyrja dhe dalja e ajrit nëpër gypa për airim, të lëmuar përbreenda, me diametër minimum 25 mm. Instalimet të cilat kalojnë nëpër gypa për airim nuk guxojnë ta zvogëlojnë prerjen e lirë të këtyre gypave më tepër se 20%.

5. Vrimat dalëse dhe hyrëse të gypave për airim/ventilim nga paragrafi 4, i këtij nenit duhet me qenë ashtu të vendosura që myllja e tyre nga papastërtia gjatë vozitjes nuk është e mundur.

6. Vrimat për airim/ventilim nga paragrafi 5, i këtij nenit duhet me qenë të larguara nga pajisja e gazzrave dalëse jo më pak 100 mm. Në rastin kur kjo distancë është më e vogël se 100 mm duhet të vendosen drejtuesit që pengojnë drejtimin direkt të ajrit për airim/ventilim në pajisjen e gazzrave dalëse, ashtu që duhet me të vendosen sa më larg nga çdo burim i shkëndisë në automjet.

7. Vrimat dalëse për airim/ventilim nga paragrafi 1, i këtij nenit për GNL duhet të vendosen sa më poshtë, ndërsa vrimat për metan sa më lartë. Në automjet në të cilin armatura e rezervuarit nuk gjendet në hapësirën për udhëtarë, bagazh ose nuk ka nevoj për ajrosje plotësuese.

8. Hapësira në të cilën është vendosur rezervari i gazit duhet me qenë në mënyrë përkatëse i ajrosur ashtu që të pengohet formimi eventual i mbi-shtypjes ndaj rrëthinës.

**Neni 36**  
**Funkcionimi i pajisjeve siguruese**

Pajisjet siguruese në rezervarin për gaz duhet plotësish me vepruar edhe kur valvola e rezervarit të gazit është e mbyllur.

**Neni 37**  
**Kyçësi për mbushje**

1. Kyçësi për mbushje duhet me konstruksionin e vet dhe realizimin të mundësojë që rezervari për gaz tē mbushet vetëm me gaz tē caktuar dhe me shtypjen e lejuar tē mbushjes, të cilët i përgjigjen konstruksionit të rezervarit, dhe të pengojë rrymimin kthyes tē gazit në mënyrë tē palejuar.

2. Kyçësi për mbushje është pjesë e rrjetit për gaz me shtypje tē lartë dhe duhet tē pajiset me kapak mbrojtës.

3. Kyçësi për mbushje nuk guxon tē jetë në hapësirën për vozitës, dhe udhëtarë, duke përfshirë edhe bagazhin.

4. Kyçësi për mbushje me GNL nuk guxon tē jetë as në hapësirën e motorit.

5. Hapësira në tē cilën gjendet kyçësi për mbushje duhet me qenë e ajrosur mjaftueshëm.

**Neni 38**  
**Kyçësi për zbrasje**

1. Kyçësi për zbrasje montohet pas valvolës së rezervarit tē gazit (metanit), me qëllim tē mundësisë së zbraszës tē rrjetës dhe pajisjeve pas valvolës së rezervarit tē gazit. Zbrasia e gazit në atmosferë nuk është e lejuar. Gazi i shkarkuar duhet tē ruhet në rezervuarin përkatës.

2. Montimi i kyçësit për zbrasje tē gazit duhet tē jetë i shënuar ashtu që tē mos vij deri te zëvendësimi i këtij kyçësi me kyçësin për mbushje.

**Neni 39**  
**Montimi i valvolavo jokthyese**

1. Valvolat jokthyese duhet me qenë tē montuara në mes tē kyçësit për mbushje dhe rezervarit për gaz.

2. Në mes tē kycjes për mbushje dhe rezervuarit tē gazit duhet tē montohen 2 valvola tē pavarura ose një valvolë jokthyese dhe një valvolë me mbyllje manuale.

**Neni 40**

### **Valvola shumëkahëshe**

Valvola shumëkahëshe është valvolë e cila vendoset në mes të kyçësit për mbushje dhe rezervuarit të gazit, ndërsa realizohet si valvulë individuale ose si më shumë valvola të cilat sigurojnë veprim nga neni 15. i këtij Udhëzimi.

#### **Neni 41 Matësi i shtypjes për metan**

1. Matësi i shtypjes për metan duhet të vendoset në afersi të kyçësit për mbushje edhe në kabinë, në fushën e dukshme të ngasësit. Në vend të matësit të shtypjes në kabinë mund të montohet çfarëdo instrumenti i cili tregon sasinë e gazit në rezervuar.
2. Bartja e sinjalit në matësin e shtypjes, respektivisht në instrument nga paragrafi 1. i këtij neni duhet me qenë e tillë që në rast të thyerjes së tij nuk mund të vij deri te rrjedhja e gazit,
3. Treguesi i sasisë së gazit për GNL duhet të pengoj mbushjen e mëtutjeshme me gaz atëherë kur të mbushet 80% nga vëllimi i rezervuarit,
4. Nëse treguesi i sasisë së gazit për GNL gjendet në rezervuar të gazit, leximi i tij duhet me qenë i mundshëm pa heqjen e shtëpizës së mbrojtëse.

#### **Neni 42 Pastruesi i gazit i shtypjes së lartë**

1. Pastruesi i gazit i shtypjes së lartë vendoset në gyp në mes rezervuarit të gazit dhe valvolës së gazit dë përforcohet në karroceri ose në kornizën e automjetit.
2. Pastruesi i gazit i shtypjes së ulët vendoset në gyp në mes të rregullatorit të shtypjes dhe stabilitimit i cili mundeson prurjen e gazit në motor.

#### **Neni 43 Avulluesi i gazit për GNL**

1. Avulluesi i gazit për GNL përforcohet në anën e brendshme të karrocerisë të automjetit jashtë hapësirë së vozitës dhe udhëtarëve, duke përfshirë edhe bagazhin.
2. Avulluesi i gazit nuk guxon të përforcohet në asnjë pjesë të automjetit e cila është në temperaturë të lartë kur është në gjendje pune.

#### **Neni 44 Rregulatori i shtypjes**

1. Rregulatori i shtypjes, i realizuar individualisht ose së bashku me avulluesin e gazit, montohet në hapësirën në të cilën është vendosur motori, dhe atë sa më afër pajisjes (karburatorit) e cila e futë gazin si lëndë djegëse në motor, ndërsa përforcohet në karroceri ose kornizë të automjetit. Rregulatori i shtypjes nuk guxon të përforcohet për motorin e automjetit.

#### **Neni 45 Montimi i valvolës së gazit**

1. Valvola e gazit montohet në gyp të gazit të shtypjes së lartë në mes pastruesit të gazit dhe avulluesit të gazit respektivisht rregullatorit të shtypjes, ndërsa montohet në kornizë të automjetit,

2. Ndërpërësi për kyçje dhe çkyçje të gazit duhet të jetë për ngasësin më afër dorës,

3. Valvola e gazit mundet me qenë e montuar në shtëpizën e ngushtë të njëjtë për gaz me pastruesin e gazit dhe montohet njësoj si valvolë e gazit pa pastrues,

4. Valvola e gazit mundet me qenë e montuar në shtëpizën e ngushtë të njëjtë për gaz me avulluesin e gazit respektivisht rregullatorin e gazit dhe montohet njësoj si edhe avulluesi i gazit, respektivisht rregullatori i gazit.

**Neni 46**  
**Gypat për gaz të shtypjes së lartë**

1. Gypat për gaz të shtypjes së lartë, të punuar nga gypat prej bakrit, nuk guxojnë të ngjiten e as të saldohen por mund të lidhen me pjesët përlidhje të punuar nga bronzi ose çeliku;

2. Gypat për gaz të shtypjes së lartë, të punuar nga gypat prej çelikut, bashkohen me saldim ose me lidhëset ndarëse përga. Lidhjet me bulona lejohen vetëm nëse prodhuesi vërteton me prova nën shtypje të cilat i përgigjen këtij përdorimi,

3. Gypat për gaz të shtypjes së lartë, të punuar nga materialet kompozite, bashkohen me pjesw të veçanta të gypave përlidhje.

4. Gypat për gaz të shtypje së lartë duhet të janë ashtu të shtrira që të mos vij deti te lëkundjet vetjake dhe të mos ketë kontaktim mes veti të pjesëve, veçanërisht në vendet e têrheqjes së gypave nëpër vrima. Distanca në mes të dy vendeve përforcuese, përgat e shtypjes së lartë në automjet, guxojnë me qenë më së tepërm 600 mm, ndërsa rrezet e lakesës së gypave duhet me iu përshtat materialit dhe dimensioneve të gypave. Gypat mund të janë të përforcuar me lidhëse nga plastika.

5. Në hapësirën përvazitës dhe udhëtarë, duke përfshirë edhe bëgazhin, rrjetat gypore për gaz montoohen vetëm nëse janë të mbrojtura posaçërisht (gypi në gyp dhe ngjashëm), ashtu që ajò mbrojtje duhet me qenë rezistente ndaj dëmtimeve mekanike ndërsa vrimat e saj duhet me qenë në anën e jashtme të automjetit,

6. Para lidhjes me pajisjet (ventilin e gazit, avulluesin, pastruesin dhe ngjashëm) rrjetat për gaz duhet me pas dordon kompenzuese e cila mundëson lirimin,

7. Në gypat për gaz të shtypjes së lartë, nuk lejohet të ketë dëmtime të dukshme, ndërsa rrjetat e korroduara, të plasaritur ose në ndonjë mënyrë tjetër të dëmtuara duhet pasi të vërehen dëmtimet patjetër të zëvendësohen.

**Neni 47**  
**Gypat për gaz të shtypjes së ultë**

1. Gypat për gaz të shtypjes së ultë të cilat lidhin avulluesin, respektivisht rregullatorin e shtypjes me pajisjet në të cilin formohet përzierja e lëndës djegëse dhe ajrit për ngasjen e motorit nuk guxojnë me qenë në kontakt me pajisjet përlidhje (kolektorët e zbratzes së gazzave), respektivisht motorin, përvëç me stabilimentin përfurnizimin e motorit me lëndë djegëse.

2. Rrjetat për gaz të shtypjes së ulët lidhen me fileto ose me dado. Lidhjet duhet me qenë hermetike. Dadot duhet të jenë vetë frenuese që të mos vijë deri te lëshimi i pakontrolluar.

3. Në gypat për gaz të shtypjes së ultë nuk guxon të ketë dëmtime të dukshme, ndërsa rrjetat e korroduara, të plasaritura ose në mënyrë tjetër të dëmtuara duhet të zëvendësohen.

**Neni 48**  
**Gypat për prurjen e mediumit për ngrohje deri te avulluesi i gazit**

1. Gypat për prurjen e mediumit për ngrohje deri te avulluesi i gazit, respektivisht rregullatori i shtypjes realizohen si gypa përkulës të cilët duhet me qenë rezistues në ndikimet kimike të fluidit punues i cili nëpër ta rrjedhë dhe duhet të përballojnë shtypjen punuese dhe temperaturën e fluidit punues.

2. Gypat nga paragrafi 1 i këtij nenit, vendosen ashtu që në rrugën më të shkurtër, pa kënde të ngushta, lidhin burimin e nxehësisë më avulluesin, respektivisht rregullatorin e shtypjes. Lidhjet e këtyre rrjetave sigurohen me dado,

3. Në gypat për prurje të fluidit për ngrohje nuk guxon me pas dëmtime të dukshme, ndërsa gypat e korroduara, të plasaritura ose ndonjë mënyrë tjetër të dëmtuar duhet të zëvendësohen.

**Neni 49**  
**Montimi i valvolës së lëndës djegëse të lëngët**

1. Valvola e lëndës djegëse të lëngët montohen në rrjetën e lëndës djegëse (benzinës, dieselit), në mes të pompës së lëndës djegëse dhe stabilimentit përfurnizim të motorit me lëndë djegëse

2. Valvola e lëndës djegëse të lëngët nga paragrafi 1 i këtij nenit nuk montohet nëse me zgjedhjen e gazit si lëndë djegëse, njëherit ç'kyçet nga furnizimi prurja e lëndës djegëse të lëngët në pajisjen përfurnizim të motorit me lëndë djegëse.

**Neni 50**  
**Rrjetat e instalimeve elektrike**

1. Rrjetat e instalimeve elektrike duhet me qenë të dimensionuara dhe vendosura ashtu që mos të krijojnë fërkim me bazë në të cilën shtrihen. Lidhjet e skajeve elektrike duhet me qenë të realizuara ashtu që të mos shkaktojnë shkëndija,

2. Instalimi elektrik duhet me qenë e siguruar me siguresë shkrirëse.

**Neni 51.**  
**Senzoret e shtypjes dhe te temperaturës**

Senzoret e shtypjes dhe te temperaturës, montohen si pjesë të stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz me qëllim të dërgimit të informatave dhe punës pëfecizë të njësisë kontrolluese elektronike. Senzorët e shtypjes dhe te temperaturës mund të realizohen në tërësi me ndonjë tjetër stabiliment.

**Neni 52**  
**Stabilimenti për injektim të gazit**

Stabilimenti për injektim të gazit montohet në hapësirën e motorit në vendin më të afërt të formimit të përzierjes para hyrjes në cilindër.

**Neni 53  
Shpërndarësi – distributori**

Shpërndarësi – distributori montohet në hapësirën e motorit në vendin më të afërt të formimit të përzierjes para hyrjes në cilindër.

**Neni 54  
Njësia kontrolluese elektronike**

Njësia kontrolluese elektronike duhet të jetë e përforuar në karroseri ose në korniz të automjetit dhe e mbrojtur nga ndikimet e jashtme

**Neni 55  
Pompa e shtypjes së lartë**

Pompa e shtypjes së lartë montohet brenda ose jashtë rezervuarit të gazit.

**Neni 56  
Etiketa me simbolin e gazit të përdorur si lëndë djegëse**

Në mbrojtësin e erës respektivisht në qelqin e prapmë të kabinës së automjetit me ngasje me gaz duhet të gjendet etiketa me simbolin e gazit të përdorur si lëndë djegëse. Përbajtja, forma dhe dimensionet e etiketës janë paraqitur në skicën 1 (shtoja 1), i cili është shtypur së bashku me këtë Udhëzim edhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 57  
Automjeti**

1. Para futjes së automjetit në hapësirën e punëtorisë për servisim, si dhe para kryerjes së punëve në automjetin motorik me ngasje me gaz, tekniku për montim duhet të verifikoj a rrjedhë gazi nga pajisja e gazit.

2. Nëse verifikon rrjedhjen e gazit nga stabilimentet dhe pajisjet për ngasje të automjeteve motorike me gaz, tekniku për montim me mylljen e rezervuarit të gazit do të evitoj irrezikun para fillimit të punëve të mëtuteshme.

3. Para fillimit të punëve në automjetin motorik me ngasje me gaz tekniku për montim duhet të provoj përqendrimin e gazit në punëtori dhe sipas nevojës të kyçet ajrimi/ventilimi.

4. Përqendrimi i gazit në hapësirën e punëtorisë për shërvishim dhe në hapësirën e automjetit nuk guxon ta tejkaloj përqendrimin e rezikshëm sipas nenit 2 pikë 3 të këtij udhëzimi.

5. Kur farë punësh në rezervuar të gazit nuk janë të lejuara.

**Neni 58**

### Ndryshimet në automjet

1. Montimi i stabilimenteve dhe pajisjeve për gaz për ngasje të automjetit motorik konsiderohet modifikim në automjet.
2. Pas montimit të stabilimenteve dhe pajisjeve për ngasje të automjeteve motorike me gaz automjeti duhet të atestohet.
3. Atestimi bëhet për të verifikuar rregulluesin e montimit të stabilimenteve dhe pajisjeve për gaz, jo rjedhshmérinë e të gjitha stabilimenteve dhe lidhjeve të rrjetave gypor për gaz, në përputhje me rregullat e veçanta.

### Neni 59

Stabilimentet dhe pajisjet për ngasje të automjeteve motorike me gaz, të cilat janë montuar në automjete duhet të posedojnë miratimin adekuat sipas ECE rregulloreve për homologim të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

### Neni 60 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Prishtinë,

Data: 18/04/2013

